

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “INVESTOR ENTERPRISES”SH.P.K.

Ne Tirane , sot me date 01/12/2020 u paraqiten personalisht Ortaket si me poshte :

1. - **Zoti Ermir NDREAJ** me shtetesi dhe kombesi shqiptare, i biri i Rustemit dhe Fahries , lindur me 17/08/1981 ne Bajram Curr dhe banuese ne Ttirane madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me karte identiteti me nr, leternjoftimi 032927418 dhe nr. Personal I10817062P.
2. - **Znj Elira BARBULLUSHI** me shtetesi dhe kombesi shqiptare, e bija Besnikut dhe Hildes, lindur me 09/01/1988 ne Tirane dhe banuese ne Tirane , madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me karte identiteti me nr, leternjoftimi 033664598 dhe nr. Personal I85109039G.

Te cilet hartojne kete Akt Themelim te shoqerise “Investor Enterprises “ SHPK, me emer Tregetar “ **CLINIQUE CINQ**”. mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008,“Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“ i ndryshuar ,ligjin 9723 date 03.05.2007“Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”,Kodin Doganor,Fiskal e Tatimor,si me poshte:

KREU I Neni 1 Krijimi

Shoqeria“**Investor Enterprises “ shpk** ,me emer tregtar“ **CLINIQUE CINQ**”. eshte person juridik i te drejtes shqiptare,Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2 Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi te jete rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) ,ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj. Shoqeria pasi te kete fituar Personalitetin Juridik eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Shoqëria “**Investor Enterprises**” shpk. është një shoqëri që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3 Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë është në TIRANE , në adresën Rruga e Kavajës, Godina 3, Hyrja 1 , Zona Kadastrale 8250 Tirane , Shqipëri.

Veprimtaria e shoqërisë do të zhvillohet në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të ndryshojë seline e saj , mund të hapë adresë dytesore. Shoqëria mund të çelë degë dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato hapen dhe prishen me vendim të të Asamblesë së Përgjithshme të saj.



Neni 4 Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë: Import, Export , shërbime kozmetike, tregëti me shumicë dhe pakicë të produkteve kozmetike , veshje produkteve ushqimore, lëndë ndërtimore etj, inport dhe tregëti makina dhe automjete të ndryshme , shërbime në fushën e hotelëri , në fushën e ndërtimit, në bar resorante etj.

Neni 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë “ **Investor Enterprises** “ SHPK është pa afat dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve ligji tregtar për ndryshimin e statutit.

KAPITULLI - II KAPITALI , KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE



Neni 6 Kapitali

Kapitali i shoqërisë është .100.000 (njqind mije) i ndare ne 2 (dy) kuota.
Pronësia mbi kapitalin të shoqërisë është si më poshtë:

1. Ortaku **Z Ermir NDREAJ** , eshte zoteruese e nje kuote ne vlere 51.000 leke , qe perben 51% te kapitalit themeltar.
2. Ortaku **Znj Elira BARBULLUSHI** , eshte zoteruese e nje kuote ne vlere 49.000 leke , qe perben 49% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë,ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar,si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3(tre)vjetëve nga çasti i cenimit.



Neni 7 Menyra te fitimit dhe Kalimit te Kuotave

Kuota te kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a)kontributit në kapitali ne shoqërisë;
- b)shitblerjes;
- c)trashëgimisë;
- ç)dhurimit;
- d)çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

1..Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë,kontrata duhet të bëhet me shkrim.
2.Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave,veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
3.Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë,kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën,si dhe kushtet e tjera të kalimit,përfshirë momentin e pagesës së çmimit,rregullohen nga kontrata.Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.
Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë,vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ,përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III



ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financiar.
- j) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerise nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator Ermir NDREAJ cila sipas statutit dhe ligjit emerohet per nje periudhe 5 - vjecare me te drejte ripertesitje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoren në çdo kohë me shumicë të zakonshme.Statuti,apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj,administratorja shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administrores dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administrores prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;



e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm.Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj,autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja,përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkalleve,prokurorive të të gjitha shkalleve,bankat e të gjitha niveleve etj.Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë,si përpara Bankave të të gjitha niveleve,per të kryer derdhje,terheqje,transferta etj,përpara Zyrave të Tatimit Taksave,Zyrave të Qeverisjes Vendore,Zyrave të Punës,Autoriteteve Doganore etj,në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11 Viti Financiar



Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht,viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne Akt Themelim ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejte juridike,ne gjuhen shqipe,u

miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare “ **Investor Enterprises** “ SHPK “,nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin,mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ortaket themelues

te shoqerise “ **Investor Enterprises** “ SHPK

1. **ERMIR NDREAJ**
2. **ELIRA BARBULLUSHI**

Elira Barbullushi

Elira Barbullushi

ERMIR NDREAJ

ERMIR NDREAJ